



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 447/25 Datë: 23.04.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 136 të mbajtur më 14.04.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet programi i studimeve të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Teknologji MSc 120 ECTS, (me specializim në Inxhinieri të Mbrojtjes së Mjedisit), me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik.*
- II.** Riakreditohet programi i studimeve të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 - *Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.*
- III.** Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Universiteti “Isa Boletini” që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Universiteti “Isa Boletini” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim nga KShC.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Teknologji, (me specializim në Inxhinieri të Mbrojtjes së Mjedisit), MSc 120 ECTS</i>	Mensur Kelmendi Sadja Kadriu
2.	<i>Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS</i>	Bahtir Hyseni Valdet Gjinoçvi Fatos Rexhepi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Teknologji, (me specializim në Inxhinieri të Mbrojtjes së Mjedisit), MSc 120 ECTS**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Francisco Javier Farfan, Sanja Kalambura dhe Issabek Muratov është organizuar më 30.01.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht katër (4), dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje Joachim Muller, Jasna Novak dhe Juraj Bogat është organizuar më 20.02.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 136-të, të mbajtur më datë 14.04.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka ngjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë ;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë